



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 477 Prot.

Tiranë, më 23.04 2018

VENDIM Nr. 66, datë 20.03.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi dhe Prof. Dr. Roberto Perna, Universiteti i Maceratës, Itali, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"2018*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. Dhimitër Çondi dhe Prof. Dr. Roberto Perna, Universiteti i Maceratës, Itali, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Gërmimet arkeologjike do të shtrihen në sipërfaqen përballë Teatrit ku janë identifikuar ndërtesa kryesore publike, banjo, ndërtesë monumentale dhe tempulli;
 - Gërmimi në Melan që do të japë një stratigrafi kronologjike të jetës së qytetit dhe të mureve fortifikues të periudhës Helenistike dhe Bizantine;
 - Restaurimi arkeologjik: Punimet e restaurimit në mure do të kryhen me referencën dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm të Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë dhe zyrave të saj periferike të Gjirokastrës. Restaurimi dhe konsolidimi i strukturave që do të dalin në dritë gjatë gërmimeve të reja dhe mirëmbajtja e atyre që janë ndërtuar që nga viti 2011.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Ëëbsite: asha.gov.al

3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen strukturë, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Ëëbsite: asha.gov.al